



Nr. 282/1 Prot.

Nr. 2749/1 Prot.

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
MIDIS
KOLEGJIT UNIVERSITAR
“INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË”
DHE
BASHKISË TIRANË

E lidhur sot më 14.05 2021 midis palëve:

KOLEGJIT UNIVERSITAR “INSTITUTI KANADEZ I TEKNOLOGJISË” (CIT), person juridik, i regjistruar në QKB, me NIPT numër L1161401R, i përfaqësuar nga **Prof. Dr. Sokol Abazi**, Rektor i Institucionit, CIT.

dhe

Bashkia e Tiranës, me adresë: “Sheshi Skënderbej”, nr. 2, kodi postar 1001, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga **Z. Erion Veliaj**, Kryetar, në vijim e cilësuar si **“Bashkia”**

BEKAS

Duke qënë se:

Interesi dhe dëshira e mirë e të dy institucioneve për të bashkëpunuar me njeri-tjetrin, me qëllim ofrimin për studentët e CIT të zhvillimit të praktikës dhe trajnimit sipas nevojave të tregut të punës. Studentët nëpërmjet praktikave dhe trajnimeve profesionale do të krijojnë mundësi për të marrë një eksperience pune, si dhe do të zhvillojnë e zgjerojnë dijet e fituara në shkollë duke rritur mundësitë për punësim.

Palët lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi si më poshtë vijon:

Neni 1 Objekti

Objekti i marrëveshjes është bashkëpunimi midis palëve në lidhje me zhvillimin e praktikave pranë Bashkisë Tiranë, për studentët e CIT.

Neni 2 Baza Ligjore

Kjo marrëveshje bazohet në ligjin nr. 7850, datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) dhe ligjin 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar).

Neni 3 Angazhimet e Palëve

Palët bien dakord të bashkëpunojnë në frymën e një mirëkuptimi reciprok si dhe me vullnetin pozitiv për të siguruar kushtet e nevojshme për realizimin e angazhimit dhe iniciativat e ndërmarra nga njëra palë ose në bashkëpunim.

CIT angazhohet të dërgojë listën me emrat e studentëve të cilët do të kryejnë praktikën pranë Bashkisë Tiranë.

Për periudhën e praktikës, studentët janë të detyruar t'i nënshtrohen rregullave dhe kërkesave të Bashkisë Tiranë.

Bashkia do të ofrojë kushtet e nevojshme për kryerjen e praktikës me qëllim përfitimin nga ana e studentëve të një kualifikimi sa më cilësor.

Çdo student në përfundim të praktikës do të marrë një certifikatë/vërtetim nga Bashkia e Tiranës.

Neni 4 Njoftimet

Të gjitha njoftimet dhe komunikimet midis palëve në këtë marrëveshje bëhen nëpërmjet personave të kontaktit si më poshtë vijon:

Për Bashkinë:

Znj. Natali Shkëmbi

Specialist, në Sektorin e Trajnim Zhvillimit,
Drejtoria e Procedurave të Burimeve
Njerëzore dhe Trajnim Zhvillimit
email: natali.shkembi@tirana.al

Për CIT:

Z. Ubejd Osmani

Administrator

email: adminstratoroffice@cit.edu.al

Në rast ndryshimi të personit të kontaktit palët duhet të njoftojnë njëra-tjetrën, në mënyrë që komunikimi të vijojë normalisht.

**Neni 5
Dispozitat e fundit**

Palët përgjigjen reciprokisht për respektimin e kësaj marrëveshje.

- Kjo marrëveshje lidhet me afat 1 vjeçar;
- Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga palët;
- Kjo marrëveshje mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht me shkrim palën tjetër;
- Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje të barazvlefshme në gjuhën shqipe, nga 2 (dy) kopje origjinale për secilën palë.

**Kolegji Universitar
“Instituti Kanadez i Teknologjisë”**

Rektor

Prof. Dr. Sokol ABAZI



Bashkia Tiranë

Kryetari

Z. Erion VELIAJ

